



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1088 Dt 30.09.2021

Mbështetur në vendimin e qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/37 të datës 24.9.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, respektivisht pika 20, dhe rekomandimin e Konferencës së Rektorëve të dt. 25.09.2021, Senati i Universiteti “Isa Boletini”, në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 27.9.2021, mori:

Vendim

1. Të gjitha aktivitetet e pezulluara, si pasojë e vendimit të Qeverisë 01/35 të datës 12.9.2021 (provimet e mbetura të afatit të shtatorit si dhe provimet pranuese për pranimin e studentëve të rinj), do të fillojnë të zhvillohen duke filluar nga data 27 shtator 2021, sipas orareve të njësive akademike, më së largu deri më 15 tetor.
2. Si pasojë e pezullimit dyjavor të aktiviteteve mësimore, procesi mësimor – ligjëratat do të fillojnë më 15 tetor 2021 me prezencë fizike.
3. Procesi mësimor, respektivisht ligjëratat, do të zhvillohen duke respektuar udhëzuesit përkatës, me kusht që numri i studentëve në një klasë të mundësojë në mënyrë rigoroz mbajtjen e distancës prej 1.5 metra në mes të personave.
4. Në rastet e caktuara, dhe për të respektuar distancën prej 1.5 metra, ligjëratat do të organizohen në dy grupe të studentëve: Orët e mësimit në dy grupe – ora e parë 40 minuta grupi i parë i studentëve; ora e dytë 40 minuta grupi i dytë i studentëve. Në mes të dy orëve do të mundësohen 10 minuta për ndërrimin e studentëve.
5. Në raste tjera dhe varësisht edhe vendimeve të qeverisë do të mundësohen edhe orët hibride dhe on-line.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati.

Arsyetim

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/37 i datës 24.9.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, respektivisht pika 20, ka përcaktuar se procesi mësimor, respektivisht ligjëratat do të zhvillohen duke respektuar udhëzuesit përkatës, me kusht që numri i studentëve në një klasë mundëson në mënyrë rigoroz mbajtjen e distancës prej 1.5 metra në mes të personave. Për shkak të pezullimit dyjavor të aktiviteteve mësimore, si dhe bazuar në rekomandimin e Konferencës së Rektorëve, Senati i UIBM mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM
2. Njësive akademike
3. Menaxhmentit të UIBM

Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit të UIBM